



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1 Mars 2023

Nr: 81

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË RROGOZHINË,  
PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E  
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 1 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Rrogozhinë

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Rrogozhinë, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Rrogozhinë.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 1 Mars 2023

Nr: 81  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Rrogozhinë, për raportimin e veprimtarive publike”

*“Me Etjenin dhe ekipin tonë në Kryevidh për të vazhduar procesin e komunikimit me qytetarët për zgjidhjen e problematikave. Vazhdojmë bashkë punën drejt fitores së 14 Majit”.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=532070305807407&set=pcb.532070409140730>

*Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”*

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 27.2.2023, bashkisë Rrogozhinë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike

Më datë 28.2.2023, ora 3:39 PM, bashkia Rrogozhinë bën me dije se: *“...Me datë 9.2.2023, ora 18:00, kryetari i bashkisë Rrogozhinë z.Edison Memolla bashkë me të deleguarin politik të Partisë Socialiste z. Etjen Xhafaj, kanë zhvilluar një takim të organizuar nga struktura lokale e Partisë Socialiste Kryevidh me pjesëmarrës simpatizantë të Partisë Socialiste në këtë njësi. Organizator i këtij takimi është subjekti politik Partia Socialiste dhe si e tillë nuk është raportuar si aktivitet në faqen zyrtare të KQZ, pra Bashkia Rrogozhinë nuk është organizatore dhe nuk jemi në kushtet e shkeljeve të udhëzimeve për këtë aktivitet...”.*

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se bashkia Rrogozhinë nuk është organizatore e aktivitetit të sipër përmendur, për pasojë në referim të legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportimin e aktivitetit i atribuohet organizatorit të veprimtarisë publike. Ky detyrim është për institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Rrogozhinë, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

## V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Rrogozhinë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**